



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës  
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova  
Civil Aviation Authority of Kosovo



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Autoriteti i Aviacionit Civil shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Udhëheqës i Divizionit të Aerodromeve
<b>Klasa e pozitës</b>	Drejtues i Ulët
<b>Koeficienti/Paga</b>	15.5
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Kohëzgjatja e emërimit</b>	Me mandat 4 vjeçar
<b>Data e njoftimit</b>	28/03/2025
<b>Afati për aplikim</b>	29/03/2025 - 27/04/2025
<b>Institucioni</b>	Autoriteti i Aviacionit Civil
<b>Departamenti</b>	Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm
<b>Divizioni</b>	
<b>Vendi i punës</b>	Divizioni i Aerodromeve
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00017525
<b>Kodi</b>	RPC0011064



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

Udhëheqësi i Divizionit të Aerodromeve menaxhon këtë Divizion duke përfshirë implementimin e direktivave përkatëse, urdhëresave, udhërrëfyesve dhe procedurave që janë të aplikueshme për operatorët e aerodromeve në Kosovë, ofruesve të shërbimeve në tokë, dhe organizatave për aftësim profesional në fushën e aerodromeve dhe shërbimeve në tokë.

Udhëheqësi i Divizionit të Aerodromeve ka poashtu rolin dhe kompetencën e Inspektorit të Aerodromeve dhe kryen të gjitha detyrat dhe rolet që bartë ky funksion, për të cilën duhet të kryej me sukses trajnimet për mirëmbajtjen e kompetencës profesionale sipas Ligjit për Aviacionin Civil dhe akteve tjera nënligjore në fuqi të aviacionit, dhe standardeve ndërkombëtare të aplikuara nga organizatat si ICAO-s, EASA-s, etj. Përveq kësaj, përgjegjësitë e këtij roli përfshijnë fushëveprimin si në vijim:

1. Mbështet dhe ofron këshilla për udhëheqësin më të lartë administrativ / titullarin e institucionit për fushën e përgjegjësisë së Divizionit që udhëheqë.
2. Drejton dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e Divizionit dhe siguron funksionim efikas të tij, si dhe ndihmon Drejtorin e Përgjithshëm në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave.
3. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes sipas fushës së përgjegjësisë, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
4. Organizon dhe shpërndan punën për stafin të tij dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e Divizionit.
5. Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse.
6. Përgatitë raporte të detajuara periodike dhe vjetore, ato për inspektimin, që dokumentojnë gjetjet nga inspektimi, vlerësimet e sigurisë dhe statusin e gjetjeve / mospërputhjeve, vlerësimin e planeve dhe veprimeve korigjuese.
7. Ofron përkrahje profesionale brenda fushëveprimit në raste emergjente në aviacion sipas udhëzimeve të drejtorit të përgjithshëm.

Kryen detyra tjera shtesë nga fusha profesionale kur kërkohet nga Drejtori i përgjithshëm i AACK-së.

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

**Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Në inxhinieri, me përjashtim të Inxhinierisë Elektro-Teknologji.

**Kërkesat specifike:** Njohja e gjuhës angleze në nivelin B1 e sipër ose ekuivalente si Pre-Intermediate (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar, studimeve të vijuar në një universitet vendor apo jashtë vendit në gjuhën angleze ose përvojë pune në organizatat ku gjuha angleze është gjuhë zyrtare e komunikimit. Kompetencë profesionale në fushën e aviacionit, që dëshkohet me përvojë pune, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Aviacionin Civil.

- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

### 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Njohuri të gjëra e të thella të politikave, legjisllacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon Divizioni i Aerodromeve në AAC
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative.
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon.
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses Projektet e Divizionit sipas specifikave që ka AAC
- Njohja e gjuhës angleze në nivelin B1 e sipër ose ekuivalente si Pre-Intermediate (e obliguar).



## 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

### Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se(6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (Kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 12/05/2025, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net> )

## 7. Kriteret specifike shtesë

---

- Njohja e gjuhës angleze në nivelin B1 e sipër ose ekuivalente si Pre-Intermediate (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar, studimeve të vijuara në një universitet vendor apo jashtë vendit në gjuhën angleze ose përvojë pune në organizatat ku gjuha angleze është gjuhë zyrtare e komunikimit.
- Kompetencë profesionale në fushën e aviacionit, që dëshmohet me përvojë pune, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Aviacionin Civil.



## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuar me origjinalin.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

